

Trajnim për radiodifuzerët për rregullat e prezantimit mediatic zgjedhor

Shkup, 16.02.2016 – Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale nga data 15 deri më 19 shkurt 2016, do të realizojë gjashtë punëtori për radiodifuzerët rajonal, lokal dhe nacional në Republikën e Maqedonisë, përfshirë këtu edhe shërbimin publik të radiodifuzionit. Radiodifuzerët do të njoftohen me obligimet e tyre që dalin nga Kodi zgjedhor, si dhe me Metodologjinë sipas të cilës Agjencia do ta realizojë monitorimin e prezantimit mediatic zgjedhor.

Trajnimet do të realizohen sipas kësaj renditje:

–**15.02.2016** në Tetovë për radiot dhe televizionet rajonale dhe lokale në rajonin e Tetovës, Gostivarit, Pllasnicës, Rostushës (Zhirovnicës), Kërçovës;

–**16.02.2016** në Ohër për radiot dhe televizionet rajonale dhe lokale në rajonin e Ohrit, Strugës, Dibrës, Manastirit, Prilepit, Dollnenit;

–**17.02.2016** në Shtip për radiot dhe televizionet rajonale dhe lokale në rajonin e Kavadarit, Negotinës, Vallandovës, Gjevgjelisë, Shtipit, Berovës, Dellçevës, Koçanit, Sveti Nikollës, Vinicës, Pehçevës, Probishtipit, Strumicës, Radovishit;

–**18.02.2016** në Shkup për radiot dhe televizionet nacionale;

–**19.02.2016** në Shkup për shërbimet e radios dhe televizionit, të Shërbimit publik të Radiodifuzionit dhe për radiot dhe televizionet rajonale dhe lokale në rajonin e Shkupit, Kumanovës, Kratovës, Velesit.